



Pranuar / Dorezuar Primjeno/Prodato Received/Delivery	22.09.2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SPAYSHICK	6203	/2023	114



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1109/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj Demi -anëtarë, si dhe Vjollca Sinani, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1109/2023 të datës 24.08.2023 të parashtruar nga ankuesi me adresë

, kundër organit të punësimit/Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike "Kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 22.09.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Detyrohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke nxjerr akt administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi lidhur me kërkesën me Nr. Prot: 4119 të datës 10.05.2023 të parashtruar nga ankuesi.

II. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Ministrinë e Infrastrukturës (tutje MI) në pozitën e punës "Zyrtar Administrativë në NJPSH në Prishtinë" sipas ndryshim plotësimit të akt emërimit të datës 08.07.2016, me datë 10.05.2023 ka parashtruar kërkesë me nr.prot: 4119 për Sekretarin e Përgjithshëm në MMPHI për eliminimin e shkeljeve ligjore nga marrëdhënia e punës dhe kundër ndryshimit dhe plotësimit të aktit të emërimit të datës 08.07.2016 bazuar në Vendimin me nr.reference 898 të datës 25.02.2016 të nxjerrë nga Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Infrastrukturës, kurse organi i punësimit edhe përkundër afateve ligjore nuk ka vendosur në

lidhje me kërkesën e ankuesit të datës 10.05.2023, me që rast ankuesit i fillon e drejta për ankesë për shkak të heshtjes administrative të organit të punësimit.

Ankuesi për shkak të heshtjes administrative të organit të punësimit, më datë 24.08.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 5798/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 30.08.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek MMPHI. Ndërsa Këshilli me datë 06.09.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ,me rastin e shqyrtimit të kësaj ankesë ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 5798/2023 të datës 24.08.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë për eliminimin e shkeljeve ligjore nga marrëdhënia e punës e datës 10.05.2023 me nr.4119 për MMPHI; Vendimin me Nr.Prot: 5419 i datës 30.06.2023; Licencë me nr.01/21 e datës 15.02.2021; Vendimin me Nr.Prot: 6600 i datës 29.09.2022; Licencë e datës 14.12.2001; Ndryshim dhe plotësimin të aktit të emërimit të datës 08.07.2016 i bazuar në Vendimin me nr.reference 898 të datës 25.02.2013 nga Sekretari i Përgjithshëm në MMPHI; Akt emërimit të datës 04.09.2011; Email i datës 07.07.2016; Vendimin me Nr.Prot: 3310 i datës 31.03.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë datës 30.08.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 06.09.2023; Vendimin me nr.reference 898 të datës 25.02.2013 nga Sekretari i Përgjithshëm në MMPHI; Vendimin me Nr.Prot: 1626 i datës 06.04.2016; Vendimin me Nr.Prot: 1716 i datës 08.04.2016; Vendimin me Nr.Prot: 2661 i datës 27.05.2016; Vendimin me Nr.Prot: 3335/2016 i datës 16.08.2016 nga KPMSHCK; Vendimin me Nr.Prot: 3571 i datës 12.08.2016; Vendimin me Nr.Prot: 4090/2016 i datës 30.09.2016 nga KPMSHCK.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës, ka konstatuar se meqenëse nuk është nxjerr akt administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi, atëherë ekziston baza ligjore që të detyrohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, që të bëjë shqyrtimin e kërkesës me Nr. Port: 4119 të datës 10.05.2023 të parashtruar nga ankuesi dhe në lidhje me kërkesën të nxjerr akt administrativ, *sepse:*

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se nuk ka marr përgjigje lidhur me kërkesën e parashtruar dhe po ashtu nga shkresat e lëndës konstatohet se organi i punësimit edhe përkundër afateve ligjore për përgjigje në lidhje me kërkesat nuk ka vendosur në lidhje me kërkesën me Nr. Port: 4119 të datës 10.05.2023 me që rast ankuesi ka të drejtë për ankesë për shkak të heshtjes administrative përkatësisht mosveprimit të organit të punësimit.

Lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshilli, gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike-administrative, konstaton se ankuesi më datë 10.05.2023 ka parashtruar kërkesë me Nr.

Port: 4119 përmes të cilës ka kërkuar nga zv. Sekretari i Përgjithshëm në MMPHI eliminimin e shkeljeve ligjore nga marrëdhënia e punës dhe kundër ndryshim dhe plotësimit të aktit të emërimit të datës 08.07.2016 i bazuar në Vendimin me nr.reference 898 të datës 25.02.2016 të nxjerrë nga Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Infrastrukturës.

Kolegji i Këshillit, lidhur me obligimin e organit publikë që të shqyrtoj në mënyrë të drejtë kërkesën dhe të nxjerr aktin administrativ, ju referuar Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative respektivisht nenit 11 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2, i cili përcakton se: *"3. Organi u siguron personave të interesuar dhe palëve informacion të saktë, të qartë dhe të kuptueshëm rreth: 3.2. kërkesave thelbësore ligjore si dhe procedurave e formaliteteve të parashikuara për nxjerrjen e një akti administrativ apo realizimin e një akti real të kërkuar, përfshirë këtu edhe dokumentet dhe deklaratat që duhen parashtruar"*, nenit 27 paragrafi 1, i cili përcakton se: *"1. Përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, zyrtari përgjegjës zhvillon procedurën administrative, vendos për çështjen, e nënshkruan vendimin si dhe siguron njoftimin e palës"*, nenit 97 paragrafi 1, i cili përcakton se: *"1. Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon me njoftimin e një akti administrativ apo lidhjen e një kontrate administrative"*, si rezultat i kësaj, Kolegji i Këshillit ndërlidhur me bazën ligjore të potencuar si më lartë, konstaton faktin se Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në pajtim me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, është i obliguar që të shqyrtoj kërkesën me Nr. Port: 4119/06 të datës 10.05.2023 të parashtruar nga ankuesi , ndërsa pas shqyrtimit të kërkesës të nxjerr akt administrativ duke respektuar dispozitat e nenit 47 dhe 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative dhe njëkohësisht të njoftohet ankuesi me vendimin e marrë në lidhje me këtë kërkesë.

Pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.1109/2023, datë 22/09/2023

Vjollca SINANI

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në MMPHI dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

